

# "PRISHTINA ENERGJETIKE"



## Projekti "P2-P5 Dalja 1"

"P2-P5 Dalja 1" është projekt në kuadër të megaprojektit investiv në rajonin e Prishtinës.

Plani investues i KEDS në Prishtinë përfshin rritjen e kapaciteteve të linjave ekzistuese nga 10 kV në 20 kV, krijimin e linjave alternative, futjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm, zëvendësimin e 50% të linjave të tensionit të ulët. Nga këto investime do të përfitojnë direkt 90 mijë konsumatorë.

**Të dhëna specifike për projektin:** Hapja e kanaleve të reja në shtrirje prej 2 km. Do të përfshihen 12 transformatorë, vendosja e 8.6 km kablove të reja të tensionit të mesëm.

**Përfitues nga projekti "P2-P5 Dalja 1" :** 2.795 konsumatorë

**Lokacionet ku do të punohet:** Rr. Asllan Pireva, Rr. Nexhmi Llumnica, Rr. Ibrahim Bahtiri, Rr. Lidhja e Prizrenit, Rr. Llapi; Rr. Haxhi Zeka dhe Rr. Nazim Gafurri.

**Periudha e zhvillimit të projektit:** 2020 – 2021

**Përfundimi i projektit:** Korrik 2021

Gjatë zhvillimit të punimeve konsumatorët do të informohen paraprakisht 24-48 orë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale dhe aplikacionit eKesco.

